



NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shamsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 672, e-mail: info@npbanesore.com
www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit 01-360/1

Data 15.02.2023

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Neni 5 paragrafi 5.2, Neni 7, Neni 16, Neni 17, Neni 20 paragrafi 20.2, Ligji Nr.06/L-016, për Shoqëritë Tregtare, Neni 182, Statutit të Komunës së Prishtinës, Neni 70.3, dhe Statuti i Ndërmarrjes Publike Komunale "Ndërmarrja Publike Banesore" Neni 22.1.5, me konkursin e shpallur të datës 27.12.2023, për anëtar të Bordit të Drejtorëve, Komisioni Komunal i Aksionarëve në takimin e mbajtur me datën 15.02.2023 në Prishtinë, morri këtë:

VENDIM

I. Anëtarët e zgjedhur të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore sh.a., Prishtinë, janë:

1. Nuhi Halimi,
2. Kushtrim Haliti,
3. Fazile Haziri Maloku.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, janë të përcaktuara në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin e Ndërmarrjes Publike Komunale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë.

III. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë, është tre vjeçar.

IV. Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë, do të bëhet në pajtim me dispozitat e Nenit 20 të paragrafit 20.2, të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

V. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën dy të këtij vendimi, Bordi i Drejtorëve i raporton dhe i përgjigjet Komisionit Komunal të Aksionarëve.



ARSYETIM

Komisioni Komunal i Aksionarëve të "Ndërmarrjes Publike Banesore" sh.a Prishtinë, më datë 10.02.2023, ka mbajtur intervistën lidhur me konkursin publik të datës 27.12.2022, për përzgjedhjen për anëtar të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë.

Pas intervistës, kandidatët të cilët kanë arritur poentimin e nevojshëm për t'u përzgjedhur në pozitën e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë, janë: **Nuhi Halimi 67 pikë, Kushtrim Haliti 62 pikë, dhe Fazile Haziri Maloku 53 pikë.**

Komisioni Komunal i Aksionarëve të "Ndërmarrjes Publike Banesore" sh.a., Prishtinë, bazuar në listën e poentimit dhe vlerësimit të kandidatëve përgjatë intervistës, vlerësoi se kandidatët e tjerë nuk kanë arritur poentimin e nevojshëm për të qenë pjesë e Bordit të Drejtorëve të "Ndërmarrjes Publike Banesore", sh.a., Prishtinë:

Numer protokoli të aplikimit :

01-252/1 - 49 pikë

01-170/1 - 46 pikë

01-161/1 - 46 pikë

01-145/1 - 45 pikë

01-119/1 - 43 Pike

01-173/1 - 36 pikë

dhe aplikimet online

S.K. 48 pikë

Xh.L. 47 pikë,

F.M. 41 pikë,

S.M. 30 pikë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të zgjedhur, janë të përcaktuara në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin e Ndërmarrjes Publike Komunale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë.

Ndërsa, mandati i anëtarëve të zgjedhur të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë, është tre vjeçar.

Ashtu që, kompensimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ndërmarrja Publike Banesore" sh.a., Prishtinë, do të bëhet në pajtim me dispozitat e Nenit 20 të paragrafit 20.2, të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Si dhe, për kryerjen e detyrave të cekura në pikën dy të këtij vendimi, Bordi i Drejtorëve i raporton dhe i përgjigjet Komisionit Komunal të Aksionarëve.



Andaj, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Aksionarët.

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të inicioj procedurën e konfliktit adiministrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Komisioni Komunal i Aksionarëve të NPL "Ndërmarrja Publike Banesore" Sh.A- Prishtinë:

1. Vllaznim Osman

2. Granit Geci

3. Leutrim Retkoceri



T'i dërgohet:

- Arkivit të NPL "Ndërmarrja Publike Banesore" Sh.A- Prishtinë.
- Sekretarit të NPL - "Ndërmarrja Publike Banesore" Sh.A- Prishtinë.
- Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve - "Ndërmarrja Publike Banesore" Sh.A- Prishtinë.
- Kryeshefit Ekzekutiv të NPL "Ndërmarrja Publike Banesore" Sh.A- Prishtinë.
- Kandidatëve për pozitën anëtar i Bordit të Drejtorëve - "Ndërmarrja Publike Banesore" Sh.A- Prishtinë.